



NJOFTIM PËR PER PARAKUALIFIKIM PER FAZEN E I (PARË)

*Procedurë e kufizuar
(Punë)*

Në përputhje me Nenin 34 të “Rregullave të Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Tetor 2013)”

Nr. i Prokurimit: BQK 14 081 312

I. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (BQK)

Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

II. LËNDA E KONTRATËS

II.1. Titulli i aktivitetit nga BQK:

“Mbindërtimi dhe Renovimi i objektit të BQK-së”

III. LLOJI I PROCEDURËS:

Procedurë e kufizuar

III.1 PJESËT/LOTET

Nuk aplikohet

IV. NUMRI I TENDERUESVE

14 (katërbëdhjetë)

V. KRITERET PËR PARAKUALIFIKIM:

- Dorëzimi i pasqyrave financiare për 3 (tri) vitet e fundit (2011, 2012 dhe 2013) të audituara apo nëse nuk kërkohet me ligjet përkatëse, dorëzimi raporteve tjera financiare për 3 (tri) vitet e fundit (2011, 2012 dhe 2013) të cilat tregojnë gjendjen dhe përshtatshmërinë financiare të tenderuesit. Në rast të konzorciumit, lideri duhet ta plotësoj kushtin.
- Minimumi i qarkullimit mesatar vjetor për punë ndërtimore për 3 (tri) vitet e fundit (2011, 2012 dhe 2013) duhet të jetë 2 (dy) milion Euro. Tenderuesit

- kërkohet që të dorëzojnë kopje të kontratave relevante dhe/ose të pagesave të certifikuara për punë ndërtimore në mbështetje të kësaj kërkesë, Në rast të konzorciumit Lideri duhet të plotësojë 60% të kësaj kërkesë ndërsa Të gjithë partnerët tjerë duhet të plotësojnë 25% të kësaj kërkesë.
- Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka të cilat tregojnë përmbushjen e kërkesës nga ana e tenderuesit rreth resurseve financiare të tij. Në rast të konzorciumit, kushtin duhet ta plotësoj Lideri i kompanisë dhe partneri.
 - Certifikata ISO 9001 për kompanitë e licencuara për ndërtim
 - Personeli kryesor teknik:
 - Një Menaxher projekti/udhëheqës të punishtes i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimitarisë me 3 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të objekteve të natyrës së njëjtë. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit të vitit
 - Një inxhinier i Makinerisë – 5 vite përvojë pune
 - Një inxhinier i Elektrikes – 5 vite përvojë pune

(Si dëshmi duhet të sjellin CV-it përkatëse të stafit)

- Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë min. 30 të punësuar (vlen vetëm për kompaninë liderë të konzorciumit kur aplikohet)
- Dëshmi përkatëse për përvojë në realizimin e kontratave në rolin e kontraktorit dhe/ose të nën-kontraktorit gjatë 3 (tri) viteve të fundit (2011, 2012 dhe 2013) dhe me aktivitet më së paku 9 muaj gjatë secilit vit. Në rast konzorciumi kushtin duhet ta plotësoj Lideri

Realizimi i së paku 1 (një) kontrate të vlerës së ngjashme me këtë tender gjatë 3 (tri) viteve të fundit (2011, 2012 dhe 2013). Ngjashmëria e vlerës do të konstatohet në bazë të madhësisë fizike, kompleksitetit, metodave/teknologjisë së aplikuar në kontratën e tenderuesit. Në rast konzorciumi kushtin duhet ta plotësoj Lideri

VI. DHËNIA E KONTRATËS

VI.1 Emri dhe adresa e operatorëve ekonomik, të cilët janë parakualifikuar për fazën II

1. AL Trade SHPK & Euro Services SHPK, Prishtine 10000
2. Nartel, Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë 10000
3. Rexha SHPK & Tekno Ing Consulting SHPK, Rr Qytetza Pejton Prishtinë 10000

VI.2 Informacione mbi vlerën e kontratës

Te gjitha këto informata dorëzohen nga ofertuesit ne fazën e II te zhvillimit te kësaj procedure.

V. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Tetor 2013)”, respektivisht sipas Neni 41 të këtyre Rregullave, “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi.